



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 3, Datë 11. 06, 2015

Për

Miratimin në lidhje me “Problematikën e filtrimeve në pjesën e poshtëm të digës së H/C Koman”.

Në zbatim të pikës A/dh, neni 4, dhe pikës B neni 5, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, si dhe në mbështetje të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave” të miratuar me VKM nr. 147, datë 18.03.2004 Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e tij të datës 10.06.2015, mori në shqyrtim materialin e arrdhur nga KESH-i në lidhje me problematikën e filtrimeve në pjesën e poshtëme të digës së HEC-it Koman. Materiali u prezantua nga përfaqësuesit e KESH-it sh.a dhe Kryetri i KKDM.

Pas prezantimit të kësaj problematike dhe analizës e diskutimeve të anëtarëve, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha :

VENDOSI

Të miratoj Programin e punës të paraqitur nga KESH sh.a në lidhje me investigimin dhe monitorimin e filtrimeve në pjesën fundore të biefit të poshtëm të digës së Komanit, duke rekomanduar :

1. KESH sh.a, të marrë masa të shpejta për fillimin e matjeve të nivelit të ujrave nëntoksor në biefin e poshtëm përmes instalimit të piezometrave të hapura në trupin e digës si dhe kryerjen e matjeve me metoda gjeofizike dhe hidrokimike për gjetjen e rrugëve të mundëshme të burimeve të këtyre ujrave.


2. KESH-i të bëjë rekomandimet e duhura për përshtatje në projektin e punimeve për mbrojtjen nga gryrjet, në mënyrë që të garantohet realizimi me sukses i programit për matjen dhe monitorimin e filtrimeve.

3. KESH sh.a të paraqes një raport mbi kryrjen e masave të marra në lidhje me monitorimin e këtyre ujrave brenda muajit nëntor 2015.

Me respekt,

Inxh. Maksim Muçi

KRYETAR

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Maksim Muçi', written over a horizontal line.